




RE PUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. 01-1497/13
Dep. 02	Br Prot. Prot No.
Nr. llog. 02	Data 24.05.2013
Brej. shënica	Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **21.05.2013**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti** me Nr. AKK-03-909/13 për ztr. *Skender Kandic – Drejtor i Shërbimit Profesional të Shëndetit Mendor – Pejë (Ministria e Shëndetësisë), – Ministria e Shëndetësisë, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.*

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-909-13, për Zyrtarin e lartë, z. Skender Kandic – Drejtor i Shërbimit Profesional të Shëndetit Mendor – Pejë (Ministria e Shëndetësisë), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-909/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Kandic së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, ztr.Kandic është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, për të vazhduar të ushtrij funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, z. Kandic, në Agjenci ka sjellur dokumentin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPK / DPKI – 03 -1443/13) në të cilën shihet se z.Kandic ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar në ndërmarrjen private N.Sh.“Partner” në të cilën tashmë nuk ushtron asnjë lloj funksioni menaxhues.

Prandaj në bazë të provave zyrtare të ofruara e të trajtuara lidhur me këtë rast, kemi konstatuar se nuk ka pasur konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

